



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë 31.07.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 30.07.2025, të parashtruar nga operatori ekonomik Flamuri V SHPK Malishevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Llot 1 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Kraishtë, Llot 2 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Baicë”, me Nr. të Prok: 613-25-4036-5-2-1nxjerr:

V E N D I M

1. **I Refuzohet**, kërkesa për ri-shqyrtim e operatorit ekonomik Flamuri V SHPK Malishevë, e datës 30.07.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Llot 1 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Kraishtë, Llot 2 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Baicë”, me Nr. të Prok: 613-25-4036-5-2-1 kundër *Vendimit të AK –së*, të datës 25.07.2025, të publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.

Vërtetohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë për Llot 1 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Kraishtë, me Nr. të Prok: 613-25-4036-5-2-1, dhe

Vërtetohet Vendimi i AK për anulim të procedurës për Llot 2 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Baicë me Nr. të Prok: 613-25-4036-5-2-1.

2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori ekonomik Flamuri V SHPK Malishevë, me 30.07.2025, ka parashtruar ankesë lidhur me **vendimin për shpërblim me kontratë për Llot 1** dhe **vendimin për anulim të procedurës për Llot 2** të datës 25.07.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Llot 1 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Kraishtë, Llot 2 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Baicë”, me Nr. të Prok: 613-25-4036-5-2-1.

Autoriteti Kontraktues, me datë 31.07.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Lidhur me pretendimin tuaj për vendimin e AK se ka qene pjeserisht i bazuar e jo i bazuar ne teresi, ju informojme se ne si AK e kemi vleresuar dhe kemi marre vendime ne baze te ligjit ne fuqi, dhe lenda e njejt eshte kthyer ne rivlersim ku kemi kerkuar sqarime aty ku ne kemi

vlerësuar që është e nevojshme dhe vendimi ka mbetë i njëjti sepse nuk ka pas nevojë të ndryshohet asgjë, dhe ju si operatorë ekonomikë keni mundësinë që të shfrytëzohni të drejtën tuaj ankimore kurdo që e shihni të arsyeshme. Gjithashtu, ju informojmë se ankesën tuaj e kemi trajtuar në të gjitha pikat dhe ju kemi përgjigjur dhe nuk kemi pasur asnjë pretendim për favorizime siq keni pretenduar ju.

Pretendimi i juaj ankimorë se oferta e juaj për llot 2 që është në tërësi e përgjegjshme, nuk qëndron sepse të dhënia 3 është cek ndër të tjera që: ... "të gjitha ato mjete që paraqiten me faturo të blerjes duhet të kenë të bashkangjitur edhe dudin doganor".

Ne si Autoritet Kontraktues, konkretisht komisioni vlerësues nuk e ka pasur obligim që të del në teren për verifikim por ju ka mjaftuar dokumentacioni i ofruar nga ju dhe nuk është ndryshuar asnjë kërkesë e Dosjes së tenderit siq e keni cek ju në kërkesën për rishqyrtim dhe nuk kemi kërkuar më shumë se që është kërkuar në FTD dhe DT.

Lidhur me pretendimin tjetër rreth deklaratës nën betim, ju informojmë se deklaratat nën betim të grupit të operatorëve ekonomikë të propozuar për kontratë janë të plotësuara sipas legjislacionit në fuqi.

Sa i përket pretendimit tuaj lidhur me inxhinierin e ndërtimit drejtim konstruktiv, ju njoftojmë që OE i propozuar për kontratë ka këtë inxhinier me drejtim "Ndërtimtari dhe infrastrukturë specializimi Inxhinieri Strukturore dhe inxhinieria strukturore është e njëjte me konstruktiv dhe niset nga universiteti se si e specifikon, për këtë mund të konsultoheni edhe me universitetin përkatës për informata shtesë ju si OE, Inxhinieria strukturore apo konstruktiv ka të bëjë me degen e inxhinierisë civile dhe mirret me projektimin, analizen dhe ndërtimin e strukturave të ndryshme dhe objekteve tjera inxhinierike.

Lidhur me CV e gjeodetit, edhe ky pretendim nuk qëndron pasi ne si AK kemi kërkuar që Stafin profesional të deshmohet me Diplome dhe CV, pra, nuk kemi cek që CV të skanohet nga origjinali apo kopja dhe nuk mund të kërkojmë nga operatorët ekonomikë diçka që nuk e kemi kërkuar në dosjet e tenderit dhe njoftim për kontratë.

Ankesa e juaj rreth planit dinamik nuk qëndron pasi që në FTD dhe Dosje të tenderit nuk e kemi kërkuar si kriter planin dinamik.

Rreth marrëveshjes me Asfalt Group nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë dhe nga ju, as ky pretendim nuk qëndron pasi që për llot 1 paisja "Finisher" nuk ka qenë kërkesë ndërsa llot 2 e kemi anuluar pikërisht për këtë paisje.

Të deklarata nën betim e OE Arching group konkretisht nënshkrimet e pronarit, dhe nënshkrimet e punëtorëve të kontratës, për ne si AK janë të plotësuara sipas ligjit dhe nuk paraqesin ndonjë gabim.


Sa i përket pretendimit tuaj lidhur me kamionet ju njoftojmë që ky pretendim tani është i pa bazuar pasi që AK për këtë arsye e ka kthyer lenden në rivlersim dhe kemi kërkuar sqarime nga ky operator ekonomik dhe në afatën e parapare ligjor është përgjigjur dhe e ka plotësuar këtë pikë.

AK, konsideron se tenderi juaj është vlersuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit, bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Bekim Shabani

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit